



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 09.07.2019)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve:

- “Për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur” (në fushën e të drejtës administrative).
- “Për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur” (në fushën e të drejtës civile).
- “Për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur” (në fushën e të drejtës penale).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 15:10 dhe mbaroi në orën 16:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |

8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
7. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
8. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
9. *Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
10. *Marjana Papa, OSCE.*
11. *Klodian Rado, EURALIUS.*
12. *Valbona Bala (Pajo), USAID.*
13. *Përfaqësues të medias.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimeve:

- “Për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur” (në fushën e të drejtës administrative).
- “Për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur” (në fushën e të drejtës civile).
- “Për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur” (në fushën e të drejtës penale).

Naureda Llagami: Të fillojmë?

Siç edhe kemi proceduar edhe herës tjetër, të gjithë gazetarët janë të ftuar të vazhdojnë pas këtij momenti, të vazhdojnë të ndjekin mbledhjen e Këshillit dhe, kamerat, pas bërjes prezent të rendit të ditës, janë të lutur që të dalin përjashta.

Atëherë, siç jeni në dijëni, lidhur me mbledhjen e ditës së sotme të datës 9 korrik 2019... Janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe në rendin e ditës janë 5 çështje kryesore.

Çështja e parë lidhet me shqyrtimin e projektvendimeve: “Për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur” (në fushën e të drejtës administrative); “Për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur” (në fushën e të drejtës civile); “Për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur” (në fushën e të drejtës penale).

Çështja e dytë lidhet me shqyrtimin e projektvendimeve, që kanë të bëjnë me: përditësimin e listës së magjistratëve gjyqtarë udhëheqës për një periudhë trevjeçare (2017-2020)”; dhe për praktikën profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës për 2019 –2020”.

Çështja e tretë e rendit të ditës ka të bëjë: “Për shpalljen e rihapjes së procedurës për komandim të një gjyqtari në pozicionin pedagog i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës”.

Çështja e katërt ka të bëjë me krijimin dhe administrimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor të dosjes personale dhe të regjistrit të gjyqtarëve”.

Çështja e fundit e rendit të ditës është: “Për një shtesë në vendimin nr. 25, datë 07.02.2019 “Mbi informacionin periodik të kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore”.

Meqenëse nuk kemi ndonjë diskutim në lidhje me rendin e ditës, jemi dakord, unë fakt e gjej me vend që të shprehem lidhur, që pas mbledhjes së ditës së premte të datës 5 korrik 2019, kur u miratua Rregullorja “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes

së kandidatëve jo-gjyqtarë, për procedurën e përzgjedhjes për emërimin në Gjykatën e Lartë”, e cila pasoi miratimin e Rregullores “Për verifikimin e kushteve dhe kritereve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë”, mund të themi se tani kemi kurorëzuar përpjekjen disamujore të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë, për t’i hapur rrugë kthimit të funksionalitetit të Gjykatës së Lartë.

Sot Këshilli i Lartë Gjyqësor do të shpallë hapjen e garës për thirrjen e kandidaturave për anëtarë në Gjykatën e Lartë, që vijnë nga radhët e juristëve më të spikatur. Miratimi i këtij akti nënligjor, për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve për rekrutimin dhe promovimin e magjistratëve si dhe atij për kriteret e vlerësimit për kandidatët jo-gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, vendosën themelet për krijimin e standardeve të reja, të unifikuara dhe objektive për promovimin e gjyqtarëve në të gjithë nivelet, duke përfshirë edhe Gjykatën e Lartë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përmbushjen e detyrimeve kushtetuese dhe përgjegjësisë publike, për të ngritur një sistem të pavarur, efikas dhe me integritet, i ka kushtuar rëndësi saktësisht të procesit të përzgjedhjes, i cili nuk bazohet në paragjykime apo promovime interesash individuale. Tani, kemi bërë të mundur ngritjen e infrastrukturës së nevojshme ligjore për kryerjen e procesit të verifikimit të pasurisë, figurës dhe profesionalizmit për kandidatët për në Gjykatën e Lartë që vijnë nga jashtë sistemit gjyqësor, duke synuar kështu përzgjedhjen e njerëzve profesionistë me integritet, pra gjyqtarë të denjë për sistemin tonë.

Këshilli është shpresëplotë, se me hapjen e garës për në Gjykatën e Lartë shënon një hap progresi për fillimin e evadimit të një stoku prej mbi 30 mijë dosjeve, çështjeve gjyqësore të krijuar ndër vite, por edhe adresimin e shqetësimeve për çdo qytetar të Republikës së Shqipërisë, që lidhet me funksionalizimin e kësaj gjykate dhe me marrjen e drejtësisë pa vonesa.

Për të na dhënë më shumë informacion për këtë projektvendim, unë kërkoj që fjalën t’ia kaloj Kryetarit të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, zotit Toska. Faleminderit!

(Kameramanët largohen nga salla e mbledhjes.)

Ilir Toska: Ju faleminderit!

Relacion për miratimin e projektvendimit “Për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur”.

Siç dhe jeni në dijeni në mbledhjen e fundit të Këshillit të datës 5 korrik 2019, me Vendimin nr. 102, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo-gjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”, botuar në Fletoren Zyrtare të datës 8 korrik 2019, iu hap rruga nisjes së procesit të emërimit të kandidatëve jo-gjyqtarë në Gjykatën e Lartë. Ky vendim pasoi vendimin tjetër të miratuar më parë nga KLGJ-ja, Vendimin nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, përmes të cilit është rregulluar procedura që do të ndiqet për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

Ndaj sa më sipër, në kushtet e miratimit të akteve të nevojshme nënligjore për verifikimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve jo-gjyqtarë për propozimin e tyre për emërim në Gjykatën e Lartë, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, propozon projektvendimin “Për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur. Në këtë proces, Komisioni ka marrë në shqyrtim dhe ka reflektuar edhe komentet e dhëna nga Misioni EURALIUS.

Në hartimin e këtij akti, Komisioni ka pasur si qëllim identifikimin e kandidatit që përfaqëson juristin më të spikatur në kuptim të nenit 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 49, pika 1, të Ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, por edhe që ka ekspertizën e veçantë në fusha të veçanta të së drejtës, duke patur parasysh për këtë nenin 31 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në lidhje me organizimin përmes tre kolegjeve të Gjykatës së Lartë, konkretisht Kolegjit Civil, Kolegjit Penal dhe Kolegjit Administrativ, çka përcakton dhe fushat respektive të së drejtës të profilizimit të gjyqtarëve të kësaj gjykate.

Duhet theksuar fillimisht se Komisioni vlerëson shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë për 3 (tre) pozicione të lira të përhershme, duke marrë për bazë mandatet e anëtarëve të Gjykatës së Lartë.

Nga momenti i krijimit të kësaj gjykate, përbërja e saj ka qenë me 17 anëtarë, ndonëse pas ndryshimeve ligjore në vitin 2013 në Ligjin organik, ligji nr. 8588, datë 15.03.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë” (tashmë i shfuqizuar), parashikonin përbërjen e saj me 19 anëtarë.

Në kushtet, kur qe e nevojshme marrja e informacionit, për realizimin e procesit të shpalljes së procedurave të emërimit dhe bërjen e thirrjeve për kandimin nga radhët e juristëve të spikatur, për në Gjykatën e Lartë, Komisioni kërkoi nga Gjykata e Lartë një informacion në lidhje me mandatet e 19 (nëntëmbëdhjetë) gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, që janë emëruar në periudhën e fundit. Nëpërmjet këtij informacioni do të mund të merreshin të dhëna për aktet e emërimit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë, radhët nga të cilat ata ishin emëruar (gjyqtarëve ose jo-gjyqtarëve), si dhe për përfundimin e mandatit të tyre.

Nga informacioni i marrë nga Gjykata e Lartë, konstatohet se:

1. Z. {...} - është emëruar nga radhët e jo-gjyqtarëve, ndërsa mandati i tij nuk i ka mbaruar.

2. Z. {...} - është emëruar nga radhët e jo-gjyqtarëve. Mandati i tij 9-vjeçar ka mbaruar, por vijon ushtrimin e detyrës deri në zëvendësimin nga një anëtar tjetër. Pozicioni i tij konsiderohet i lirë.

3. Z. {...} - është emëruar nga radhët e gjyqtarëve. Mandati i tij 9-vjeçar është pezulluar, për shkak të zgjedhjes së tij si anëtar i këtij Këshilli për një periudhë 3-vjeçare.

4. Znj. {...} - është emëruar nga radhët e gjyqtarëve. Mandati i saj ka përfunduar për shkak të deklarimit të saj fajtores për veprën penale të korrupsionit me Vendim gjyqësor të formës së prerë. Pozicioni i saj është i lirë.

5. Z. {...} - është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Lartë nga radhët e jo-gjyqtarëve. Mandati i tij ka mbaruar me Vendimin e mbledhjes së përgjithshme të Gjykatës së Lartë të datës 21.04.2016, ndërsa pozicioni i tij konsiderohet i lirë.

6. Znj. {...} - është emëruar anëtare e Gjykatës së Lartë nga radhët e gjyqtarëve. Mandati i saj ka mbaruar, për shkak të dorëheqjes, me Vendim të mbledhjes së përgjithshme të Gjykatës së Lartë të datës 31.01.2017, ndërsa pozicioni i saj konsiderohet i lirë.

7. Znj. {...} - është emëruar anëtare e Gjykatës së Lartë nga radhët e jo-gjyqtarëve. Ndërsa mandati i saj 9-vjeçar ka mbaruar, për shkak të deklarimit të mbarimit të mandatit, nga mbledhja e përgjithshme e Gjykatës së Lartë të datës 29.06.2017. Ndërkohë që me Vendimin nr.67, datë 24.04.2019, KLGJ-ja ka deklaruar mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion të lirë në gjykatë apeli. Pozicioni i saj konsiderohet i lirë.

8. Znj. {...} - është emëruar anëtare e Gjykatës së Lartë nga radhët e jo-gjyqtarëve. Ndërsa mandati i saj 9-vjeçar ka mbaruar, për shkak të deklarimit të mbarimit të mandatit, nga mbledhja e përgjithshme e Gjykatës së Lartë të datës 29.06.2017. Ndërkohë që me Vendimin nr.66, datë 24.04.2019, KLGJ-ja ka deklaruar mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion të lirë në gjykatë apeli. Edhe pozicioni i saj konsiderohet i lirë.

9. Z. {...} - është emëruar anëtar i Gjykatës së Lartë nga radhët e jo-gjyqtarëve. Ndërsa mandati i tij 9-vjeçar ka mbaruar, për shkak të deklarimit të mbarimit të mandatit, me vendim të mbledhjes së përgjithshme të Gjykatës së Lartë të datës 29.06.2017. Ndërkohë që me Vendimin nr.65, datë 24.04.2019, KLGJ-ja ka deklaruar mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion të lirë në gjykatë apeli. Pozicioni i tij konsiderohet i lirë.

10. Z. {...} - është emëruar anëtar i Gjykatës së Lartë nga radhët e jo-gjyqtarëve. Ndërsa mandati i tij 9-vjeçar ka mbaruar, për shkak të deklarimit të mbarimit të mandatit, me vendim të mbledhjes së përgjithshme të Gjykatës së Lartë të datës 29.06.2017. Ndërkohë që me Vendimin nr.64, datë 24.04.2019, KLGJ-ja ka deklaruar mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion të lirë në gjykatë apeli. Edhe pozicioni i tij konsiderohet i lirë.

11. Z. {...} - është emëruar anëtar i Gjykatës së Lartë nga radhët e gjyqtarëve. Ndërsa mandati i tij 9-vjeçar ka mbaruar, për shkak të deklarimit të mbarimit të mandatit,

me vendim të mbledhjes së përgjithshme të Gjykatës së Lartë të datës 29.06.2017. Ndërkohë që me Vendimin nr.63, datë 24.04.2019, KLGJ-ja ka deklaruar mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion të lirë në gjykatë apeli. Edhe pozicioni i tij konsiderohet i lirë.

12. Z. {...} - është emëruar anëtar i Gjykatës së Lartë nga radhët e gjyqtarëve. Mandati i tij ka mbaruar, për shkak të shkarkimit të tij nga detyra me Vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të datës 07.02.2019. Pozicioni i tij konsiderohet i lirë.

13. Z. {...} - është emëruar anëtar i Gjykatës së Lartë nga radhët e gjyqtarëve. Mandati i tij ka mbaruar, për shkak të shkarkimit të tij nga detyra me Vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të datës 18.04.2019, ndërsa pozicioni i tij konsiderohet i lirë.

14. Z. {...} - është emëruar anëtar i Gjykatës së Lartë nga radhët e gjyqtarëve. Mandati i tij ka mbaruar, për shkak të shkarkimit të tij nga detyra me Vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të datës 04.02.2019. Pozicioni i tij konsiderohet i lirë.

15. Z. {...} - është emëruar anëtar i Gjykatës së Lartë nga radhët e gjyqtarëve. Mandati i tij ka mbaruar, për shkak të shkarkimit nga detyra me Vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të datës 19.04.2019. Pozicioni i tij konsiderohet i lirë.

16. Z. {...} - është emëruar anëtar i Gjykatës së Lartë nga radhët e gjyqtarëve. Mandati i tij ka mbaruar, për shkak të shkarkimit të tij nga detyra me Vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të datës 22.05.2019. Pozicioni i tij konsiderohet i lirë.

17. I fundit është z. {...} - është emëruar anëtar i Gjykatës së Lartë nga radhët e gjyqtarëve. Mandati i tij është i pezulluar për shkak se Komisionit i Pavarur i Kualifikimit ka marrë vendim për shkarkimin e tij nga detyra, ndërkohë gjyqtari ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Pozicioni i tij nuk konsiderohet i lirë.

Nga informacioni i ardhur konstatohet se nga 17 anëtarët më të fundit të Gjykatës së Lartë, 7 prej tyre kanë ardhur nga radhët e jo-gjyqtarëve dhe 10 nga radhët e gjyqtarëve. Nga 7 anëtarët e ardhur nga radhët e jo-gjyqtarëve, dy prej tyre ende janë në ushtrim të detyrës së anëtarit të Gjykatës së Lartë, ndërkohë që njërit prej tyre i ka mbaruar mandati 9-vjeçar dhe pozicioni i tij konsiderohet i lirë në mënyrë të përhershme.

Pra, në total, kemi 6 vende të lira të përhershme, të cilat ishin të plotësuar nga radhët e juristëve (pra të jo-gjyqtarëve).

Ligji i kohës “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”, ndonëse fillimisht nuk parashikonte kufizim për përbërjen e saj me anëtarë të ardhur nga radhët e jo-gjyqtarëve, me ndryshimet e tij në vitin 2013, kufizoi numrin e juristëve, në jo më shumë se $\frac{1}{4}$ e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

Ndërkohë, me ndryshimet e reja kushtetuese (neni 136 i Kushtetutës), në kuadër të Reformës në Drejtësi, por edhe legjislacioni në zbatim të tij, neni 49 i ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikën e Shqipërisë”, kanë parashikuar se “Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, ndërkohë një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës”.

Sa më sipër, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës konstaton se duke u nisur nga numri aktual i përcaktuar nga ligji për përbërjen e Gjykatës së Lartë, që është 19 anëtarë, si dhe kufizimi i përcaktuar në Kushtetutë dhe ligj, “një e pesta” e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve, numri i anëtarë jo-gjyqtarë për Gjykatën e Lartë, nga një përlllogaritje matematikore, rezulton të jetë 3,8, çka do të thotë se ky numër ka tendencë dhe afërsi me numrin “4” dhe jo me numrin “3”. Komisioni konsideron se në situatën aktuale numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë që duhet të emërohen nga radhët e jo-gjyqtarëve është 4 (katër). Përveç logjikës matematikore si më lart, në lidhje me këtë përfundim, Komisioni mban në konsideratë se numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë të emëruar nga radhët e gjyqtarëve, sipas Kushtetutës dhe ligjit, është $\frac{4}{5}$ e numrit të përgjithshëm, çka në kushtet aktuale përkthehet në 15,2 gjyqtarë, numër ky që në asnjë rast nuk mund të interpretohet se shkon drejt numrit 16, përveç se, pranimi i këtij të fundit do të çonte në zhbalancimin e raportit kushtetues për numrin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë të ardhur nga radhët e gjyqtarëve dhe atyre të ardhur nga radhët e jo-gjyqtarëve. Dhe po ashtu, Komisioni mban në konsideratë edhe atë çka pritet të ndodh në një të ardhme të afërt sa i përket numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, ku referuar stokut të dosjeve gjyqësore,

ky numër është e kuptueshme, përveç se do të jetë i plotpjesëtueshëm me numrin 5, do të jetë më i lartë se numri aktual prej 19 gjyqtarësh, çka do të thotë se përfundimi si më lart i Komisionit për shpalljen e procedurave për emërimin në 3 pozicione të lira është një përfundim i drejtë.

Mbi këtë bazë, duke vlerësuar numrin e pozicioneve të lira të përhershme, Komisioni ka vlerësuar që numri i pozicioneve të lira që duhet të shpallen në kuadër të procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të jetë 3 (tre).

Lidhur me përmbajtjen e projektvendimeve, por çdo pozicion të lirë, secili prej projektvendimeve përbëhet nga 4 Krerë, strukturuar në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 5 të nenit 48 në lidhje me pikën 4 të nenit 49, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Konkretisht, në Kreun I, mbështetur edhe në nenin 31 të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet shpallja e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërja e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë varësisht sipas fushave të së drejtës, referuar të cilave është e organizuar, në kolegje, Gjykata e Lartë. Ndaj për këtë qëllim, sipas secilit prej projektvendimeve, kemi shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, për çdo pozicion të lirë, sipas ekspertizës së veçantë në secilin prej tre fushave të së drejtës, pra civile, penale dhe administrative.

Në Kreun II, titulluar “Afati i kandidimit”, projektvendimet përcaktojnë afatin brenda të cilit kandidatët mund të aplikojnë për një nga pozicionet e lira të shpallura në Gjykatën e Lartë, duke vendosur një afat dyjavor, që është afati minimal i përcaktuar nga ligji, me qëllim përshpejtimin e procedurave të emërimit.

Në Kreun III, titulluar “Informacioni dhe dokumentacioni që i bashkëlidhet kandidimit”, projektvendimet rregullojnë informacion për procedurat e emërimit dhe për dokumentacionin e kandidimit.

Kështu pika 1 përcakton se çdo jurist që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenin 136, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si

dhe në nenin 49, pikat 1, 2 dhe 5, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ftohet të marrë pjesë në këtë procedurë konkurrimi të hapur publike dhe të paraqesë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dokumentacionin sipas pikës 6 të këtij Kreu.

Ndërsa, në pikën 2 të këtij Kreu, janë parashikuar kushtet që duhet të plotësojë kandidati për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë të cilat përcaktohen nga nenit 136, pikat 2 dhe 3, të Kushtetutës, që janë: a) të ketë vjetërsi në profesion, prej 15 vjetësh, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës; b) të mbajë gradë shkencore në drejtësi; c) të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit.

Në pikën 3 të këtij Kreu përcaktohet se kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 2, duhet të plotësojë edhe kriteret, sipas nenit 48, pika 3, shkronja “c” dhe pika 5, si dhe nenit 49 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të tilla si : a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; b) të jetë shtetas shqiptar; c) të mos jetë i dënuar me vendim penal të formës së prerë; ç) të mos jetë i larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi; d) të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990; dh) të mos ketë qenë dhe të mos jetë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete; e) të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas ligjit.

Më tej, në pikën 4 të këtij Kreu parashikohet se plotësimi i kushteve dhe kriterëve të mësipërme verifikohet sipas kërkesave dhe procedurës së përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”.

Kurse pika 5 e Kreut 3 parashikon se kandidati që përmbush kushtet dhe kriteret e parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij Kreu, vlerësohet, pikëzohet dhe renditet sipas kërkesave dhe procedurës së përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.

102, datë 05.07.2019, “Për kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo-gjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”.

Për sa i përket dokumentacionit të kandidimit, pra dokumentacionit që kandidati duhet të paraqesë në momentin e aplikimit, ai përcaktohet në pikën 6 të këtij Kreu, ku listohen në mënyrë shteruese si më poshtë këto dokumente: a) kërkesa për shprehjen e interesit për të kandiduar për pozicionin e lirë, sipas kërkesave të shpallura; b) jetëshkrimi, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail); c) fotokopje të kartës së identitetit; ç) dokumentacioni shoqërues nëpërmjet të cilit vërtetohet përmbushja e kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij Kreu.

Kreu i fundit i projektvendimeve, pra Kreu IV, përcakton vendin ku duhet të dorëzohet dokumentacioni i kandidatëve sipas pikës 6 të Kreut III, që është pikërisht Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Së fundmi, parashikohet që projektvendimi të hyjë në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky është edhe relacioni i përgatitur dhe projektvendimet për pikën e parë të rendit të ditës. Faleminderit!

Naureda Llagami: Kemi ndonjë koment apo ndonjë sugjerim lidhur me projekt-aktin e propozuar nga Komisioni përgjegjës përmes kryetarit?

Zonja Kadi!

Brunilda Kadi: Faleminderit, Kryetare!

Atëherë, ne pjesën e projektvendimeve që paraqiten sot për votim i kemi diskutuar pothuajse paraprakisht të gjithë anëtarët. Thjesht doja të theksoja tek pjesa e relacionit diçka që ne e kemi diskutuar dhe menduam që kjo është zgjidhja më e mirë, në lidhje me pozicionet që po shpallim sot në projektvendime, që sipas ligjit për Statusin, pozicionet në fakt, përcaktimi i pozicioneve që është e lidhur me kolegjet që duhet të ketë Gjykata e Lartë është kompetencë e Këshillit të Gjykatës që do jeë edhe Këshilli i Gjykatës së Lartë që aktualisht nuk funksionon, për shkak të situatës së jashtëzakonshme në të cilën ndodhet Gjykata e Lartë. Kështu që, në këto kushte, Këshilli nuk ka mënyrë tjetër se si të procedojë dhe me këto shpallje pozicionesh që ne kemi vlerësuar, domethënë nga Komisioni, dhe pak a shumë kemi rënë dakord të gjithë, duke caktuar sot

tre pozicione të lira, domethënë secili pozicion për një nga tre kolegjet që duhet të ketë Gjykata e Lartë. Mendoj që duhet theksuar kjo sepse është diçka jo normale, me atë që parashikon ligji për ndarjen e këtyre dhomave. Faleminderit!

Naureda Llagami: Kemi ndonjë sqarim?

Atëherë, zonja Kadi, keni propozim konkret?

Brunilda Kadi: Jo, jo! Ishte thjesht sqarim tek pjesa e relacionit.

Naureda Llagami: Atëherë, jemi dakord t'i hedhim projekt-aktet për votim?

Atëherë, kalojmë për votim projekt-aktin e parë i cili ka të bëjë me: Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e së drejtës administrative. Dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projekt-aktin e parë sipas propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Hedhim për votim projekt-aktin e dytë, i cili ka të bëjë me: Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e së drejtës civile.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi projekt-aktin, në bazë të propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Kalojmë në projekt-aktin e tretë për votim, i cili ka të bëjë me: Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e së drejtës penale.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 09.07.2019)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve:

- “Për përditësimin e listës së magjistratëve gjyqtarë udhëheqës për një periudhë trevjeçare (2017-2020)”;
- “Për praktikën profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës për periudhën korrik 2019 – qershor 2020”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 15:10 dhe mbaroi në orën 16:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 7. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 8. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 9. Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 10. Marjana Papa, OSCE.*
- 11. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 12. Valbona Bala (Pajo), USAID.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimeve:

- “Për përditësimin e listës së magjistratëve gjyqarë udhëheqës për një periudhë trevjeçare (2017-2020)”;
- “Për praktikën profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës për periudhën korrik 2019 – qershor 2020”.

Naureda Llagami: Sipas rendit të ditës, kalojmë në çështjen e dytë të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me dy projektvendime. Së pari është lidhur me: Përditësimin e listës së magjistratëve gjyqarë udhëheqës, për një periudhë trevjeçare (2017-2020). Dhe

projektvendimi i dytë ka të bëjë me praktikën profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës 2019-2020 – Relatimi i të cilave do të bëhet nga zonja Brunilda Kadi.

Brunilda Kadi: Faleminderit!

Atëherë, nga ana e Këshillit është miratuar vendimi nr. 37, datë 28.02.2019 “Për praktikën profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës”, në të cilin është vendosur që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe ajo administrative e shkallës së parë Tiranë, do jenë gjykata që do shërbenin për kryerjen e praktikës profesionale për kandidatët magjistratë, profili gjyqtar, të vitit akademik 2017-2020. Në piken 2 të këtij vendimi është miratuar edhe lista e gjyqtarëve udhëheqës për një periudhë trevjeçare (2017-2020), me të drejtë riemërimi, sipas listës bashkëngjitur.

Nga dokumentacioni që është përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, gjatë kësaj periudhe, pra nga data e këtij vendimi, deri sot, janë trajnuar dhe plotësojnë kriteret sipas verifikimit që është bërë nga Komisioni, edhe 11 gjyqtarë të tjerë, emrat e të cilëve janë në listën bashkëngjitur. Dhe Komisioni vjen me propozimin për të vendosur përditësimin e listës së magjistratëve udhëheqës për një periudhë trevjeçare (2017-2020) me të drejtë riemërimi të miratuar me vendimin nr. 37, 28.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas listës bashkëngjitur. Konkretisht emrat që i shtohen listës, që ishte sipas vendimit 37, me 22 gjyqtarë mentorë (udhëheqës), edhe 11 gjyqtarë të tjerë, që janë konkretisht gjyqtarja {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} (që i përkasin Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë) dhe, gjyqtarët {...}, {...}, {...} dhe {...}, që i përkasin Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

Atëherë, ky është projektvendimi i parë, pra thjesht përditësimi i listës së mentorëve, duke iu shtuar listës që ka qenë edhe 11 gjyqtarë të tjerë.

Kërkojmë që mbledhja plenare ta miratojë këtë vendim, për të përditësuar listën.

Naureda Llagami: Atëherë, kemi ndonjë sugjerim, koment lidhur me projekt propozimin e Komisionit? E hedhim për votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi të përditësojë listën e magjistratëve gjyqtarë udhëheqës, për një periudhë trevjeçare (2017-2020), me të drejtë riemërimi, miratuar me vendimin nr. 37, datë 28.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor sipas listës bashkëngjitur dhe të përmendur nga relatorja.

Kalojmë tek relatimi i projektvendimit të dytë.

Po, zonja Kadi!

Brunilda Kadi: Bazuar në të njëjtin vendim dhe tek vendimi që sapo u miratuar nga Këshilli, i cili sipas parashikimit, hyn në fuqi menjëherë, nisur nga dokumentacioni që ka përcjellë Shkolla e Magjistraturës, nga ana e Komisionit tonë, i prezantohet seancës plenare për të miratuar projektvendimin për të caktuar mentorët, gjyqtarët që sipas listës sapo u përditësua, për periudhën 1 korrik 2019 – 30 qershor 2020, kandidatët për magjistratë, profili gjyqtar, për vitin akademik 2019-2020, sipas ndarjes që Komisioni propozon është bërë ndarja për të gjithë vitin akademik me 3-4 mujor, për të gjithë kandidatët (janë 20 të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës), 7 janë gjyqtarët që vijnë nga radhët e ndihmësve, këshilltarët e Gjykatës së Lartë dhe 13 studentët që kanë përfunduar vitin e dytë. Është propozuar që të ndahen në 3-4 mujor, korrik-tetor 2019, nëntor-shkurt 2020 dhe mars-qershor 2020, ku secili nga kandidatët për gjyqtar do ketë mentor konkretisht një gjyqtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (Dhoma Penale), një gjyqtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (Dhoma Civile) dhe një gjyqtar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Bashkëlidhur vendimit është ndarja/lista që e keni të gjithë anëtarët, për secilin nga kandidatët. Ta lexojmë?

Atëherë, për kandidaten {...}, për katër mujorin e parë, gjyqtar tek gjykata penale është gjyqtare {...} - atëherë do flasim me shkurtime, që të mos marrim kohë - për pjesën administrative {...} dhe për pjesën e penales, gjyqtare {...}. Dhoma Civile, - më falni.

Kandidati {...}, - me këtë renditje, thjesht po lexoj emrat e gjyqtarëve – do ketë gjyqtarin {...}, {...} dhe {...}.

Për kandidaten Elona Kana, do jenë gjyqtarët {...}, {...}, {...}.

Për kandidaten {...}, gjyqtarët {...}, {...}, {...}.

Për kandidaten {...}, gjyqtarët {...}, {...}, {...}.

Për kandidatin {...}, gjyqtarët {...}, {...}, {...}.

Për kandidatin {...}, gjyqtarët {...}, {...}, {...}.

Për kandidaten {...}, gjyqtarët {...}, {...}, {...}.

Për kandidaten {...}, gjyqtarët {...}, {...}, {...}.

Për kandidaten {...}, gjyqtarët {...}, {...}, {...}.

Për kandidaten {...}, gjyqtarët {...}, {...}, {...}.

Për kandidatin {...}, do ketë gjyqtarët {...}, {...}, {...}.

Për kandidatin {...}, gjyqtarët {...}, {...}, {...}.

Për kandidaten {...}, gjyqtarët {...}, {...}, {...}.

Për kandidaten {...}, gjyqtarët {...}, {...}, {...}.

Për kandidaten {...}, gjyqtarët {...}, {...}, {...}.

Për kandidaten {...}, gjyqtarët {...}, {...}, {...}.

Për kandidaten {...}, gjyqtarët {...}, {...}, {...}.

Për kandidatin {...}, gjyqtarët {...}, {...}, {...}.

Për kandidatin {...}, gjyqtarët {...}, {...}, {...}.

Pjesa tjetër e vendimit janë pothuajse identik me vendimin 37. Pra magjistrati gjyqtar udhëheqës do të bëjë vlerësimin etik dhe profesional të secilit kandidat magjistrat, profili gjyqtar, sipas formularëve bashkëngjitur këtij vendimi duke u bazuar në kriteret dhe nivelet e vlerësimi të përcaktuar në ligj. 3 - Magjistrati udhëheqës gjyqtar, sipas pikës 4 të këtij vendimi, të përjashtohet nga hedhja e 10-të e shortit, të organizuar gjatë periudhës 1 korrik 2019 - 30 qershor 2020, për ndarjen e çështjeve në gjykatën pranë të cilës ushtron funksionin.

Pika 4 e vendimit - Magjistrati gjyqtar udhëheqës, përgjatë periudhës përkatëse që ushtron këtë veprimtari, përfiton 5 për qind shtesë page mbi pagën mujore bruto fillestare të tij. Shtesa e pagës për magjistratin gjyqtar udhëheqës i shtrin efektet nga data 1 janar 2019. Kjo është e diskutueshme. Është lapsus, është 1 korrik 2019.

Pika 5 e vendimit - Gjatë praktikës profesionale, kandidati për magjistrat, profili gjyqtar, gëzon të drejtën e pushimeve vjetore të paguara në kohëzgjatjen 25 ditë pune, nga të cilat, 15 ditë pune merren gjatë muajit gusht, në të njëjtën kohë me magjistratin udhëheqës. Kryetari i gjykatës jep pushimet vjetore, pasi konsultohet me magjistratin gjyqtar udhëheqës të tij.

Pika 6 - Për këtë vendim njoftohen Shkolla e Magjistraturës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe magjistratët gjyqtarë udhëheqës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Atëherë, për të saktësuar, tek pika 4 është një lapsus, tek vendimi që keni të printuar. Efektet i shtrin nga data 1 korrik 2019, jo në 1 janar 2019.

Ky është projektvendimi që propozohet për t'u miratuar.

Brikena Ukperaj: Jo nga data 1 korrik, sepse mund të ndodhë që në datën 1 korrik, një gjyqtar të mos jetë mentor. Domethënë, fjalia e fundit nuk ka vend për t'u thënë në këtë rast sepse nga momenti që ai do fillojë 'mentorimin', do i llogaritet periudha. Sepse mund të ndodhë që në tremujorin e parë, jo të gjithë gjyqtarët që kemi caktuar në listë mund të kryejnë 'mentorimin'. Ndoshta kjo fjalia e fundit nuk do kishte vend që ta përcaktonim.

Brunilda Kadi: Pse ku mund të jenë gjyqtarët?

Janë ata në detyrë, të gjithë.

Brikena Ukperaj: Janë, por shtesën e pagës e marrin vetëm në rast se ata do të kryejnë 'mentorimin'.

Brunilda Kadi: Do ta kryejnë ata ...

Brikena Ukperaj: Mund të ndodhë. Po pra, vetëm në rast të kryerjes së 'mentorimit'. Në qoftë se do të themi që ne kemi miratuar një listë për tre periudha katër mujore. Duke qenë se kemi miratuar një listë për tre periudha katër mujore, shtesën e

pagës do ta marrin vetëm për periudhën që ata ushtrojnë ‘mentorimin’. Ndoshta nuk ka vend të thuash “nga data 1 korrik” sepse jo të gjithë e kanë ‘mentorimin’ në datën 1 korrik. Kjo është.

Fjalja e fundit e pikës 4, duhet hequr fare sepse nuk ka sens në këtë pjesë.

Brunilda Kadi: Nga Komisioni propozohet që fjalia e dytë, e pikës 4, të hiqet. Me këtë propozim vijmë përfundimisht.

Atëherë, faleminderit zonja Kadi!

Atëherë, kalojmë projekt-aktin për votim, së bashku me propozimin e bërë në mbledhjen plenare nga vetë Komisioni, me ndryshimin në pikën 4. E hedhim për votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga Komisioni përgjegjës.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 09.07.2019)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e rihapjes së procedurës për komandim të një gjyqtari në pozicionin pedagog i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 15:10 dhe mbaroi në orën 16:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 7. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 8. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 9. Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 10. Marjana Papa, OSCE.*
- 11. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 12. Valbona Bala (Pajo), USAID.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e rihapjes së procedurës për komandim të një gjyqtari në pozicionin pedagog i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me: Shqyrtimin e projektvendimit “Për shpalljen e rihapjes së procedurës për komandim të një gjyqtari në pozicionin pedagog i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës”, projekt-akti i cili do të relatohet nga kryetarja e Komisionit për Veprimtarinë Profesionale dhe Etikës, zonja Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Sikundër jeni në dijëni, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës me vendimin nr. 6, datë 29.01.2019 ka shpallur një vend vakant në pozicionin Pedagog i Brendshëm në Departamentin e Formimit Fillestar të kësaj Shkolle. Shkolla e Magjistraturës e ka përcjellë të gjithë dokumentacionin në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për fillimin e procedurës, për komandimin e një gjyqtari.

Aktualisht, Këshilli i Lartë Gjyqësor e ka marrë në shqyrtim një herë këtë kërkesë, me vendimin nr. 33, të datës 19.02.2019 dhe ka shpallur hapjen e procedurës për komandim vetëm bazuar në kriteret e nenit 264, pika 2 e ligjit 115/2016. Kemi bërë edhe diskutim në mbledhje lidhur me kriteret ligjore që duhet të plotësonte kandidati.

Mbas kësaj është përgatitur gjithashtu, pas marrjes së kërkesave nga kandidaturat nga radhët e gjyqtarëve, është përgatitur dhe opiniononi përkatës, lidhur me dëmtimin ose jo të funksionalitetit të gjykatës, duke qenë se kemi patur dy kandidatura, vetëm nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Është vlerësuar nga Këshilli që nuk dëmtohet funksionaliteti i gjykatës në rastin konkret dhe kandidaturat janë përcjellë për vlerësim të mëtejshëm Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

Shkolla e Magjistraturës ka vendosur t'i kërkojë Këshillit rihapjen e procedurës për komandim të gjyqtarëve, pikërisht për të njëjtin pozicion (vend vakant) si Pedagog i Brendshëm.

Kërkesa na është përcjellë përsëri dhe i ka kaluar për shqyrtim Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe të Veprimtarisë Profesionale, i cili pasi ka vlerësuar, ka menduar që së pari, nuk ka asnjë pengesë për rihapjen e procedurave për komandim të një gjyqtari për pozicionin vakant të shpallur nga institucioni, për shkak sepse në zbatim të nenit 53 dhe 54 të ligjit 96/2016, nga momenti kur Shkolla e Magjistraturës është një nga institucionet që mund të kërkojë komandim të gjyqtarit, nuk ka pengesa për rihapjen e kësaj procedure. Së dyti, sipas nenit 54, Këshilli vendos rihapjen e procedurës pasi vlerëson edhe nevojat e veta. Në këtë rast, nevojat e Këshillit janë vlerësuar një herë më vendimin e shkurtit të vitit 2019 dhe deri në këtë moment, nuk ka rrethana të reja për t'u rivlerësuar ky vendim. Në këtë kuadër, kemi vlerësuar që janë rrethanat për të rihapur edhe një herë procedurën e komandimit, sipas pozicionit vakant të shpallur nga Shkolla e Magjistraturës. Bashkë me rihapjen e kësaj procedure, duhet të bëhet një njoftim i ri për

të gjithë gjyqtarët, për qëllimin, kriteret, afatin dhe procedurat e komandimit. Afati i komandimit është parashikuar, sikundër edhe në komandimin e parë, deri në 5 vjet.

Lidhur me kriteret që duhet të plotësojë gjyqtari në detyrë, që kandidon në pozicionin e pedagogut, ato janë parashikuar në nenin 264/2 e ligjit dhe lidhen me eksperiencën e punës mbi 15 vjet si gjyqtar, jurist, prokuror, avokat, bashkë me eksperiencën mësimdhënëse mbi 10 vjet. Ky është varianti i dytë në fakt i projekt-aktit, sepse sikundër edhe më parë, Komisioni ka dalë me dy variante, për shkak se varianti i parë është mbështetur në nenin 264/4 e ligjit 115/2016, duke trajtuar në mënyrë të barabartë si kriteret për pedagog të brendshëm, ashtu edhe kriteret për pedagog të jashtëm. Konkretisht në nenin 264 është parashikuar që veç kriterëve të parashikuara për pedagogët e brendshëm, nëse kandidati për pedagog i jashtëm vjen nga radhët e gjyqtarëve ose prokurorëve në detyrë, të cilët kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës, për ta mjafton eksperiencën në punë mbi 10 vjet si gjyqtar dhe eksperiencën mësimdhënëse universitare në lëndët kryesore ose në Shkollën e Magjistraturës mbi 5 vjet. Një qëndrim i tillë mbahet edhe në Rregulloren e Shkollës së Magjistraturës (Aneksi 11) si akt normativ, ku parashikohen të njëjtat kriterë, si për pedagogët e jashtëm, ashtu edhe për pedagogët e brendshëm të Shkollës së Magjistraturës. Bazuar pikërisht në parimin e trajtimit të barabartë dhe të të njëjtave kriterë, si për pedagogët e brendshëm ashtu edhe të jashtëm, në variantin nr. 1 të projekt-aktit është parashikuar që veç kriterëve të parashikuara në nenin 264/2 e ligjit, gjyqtari në detyrë që ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës dhe kandidon për komandim në pozicionin e mësipërm, duhet të ketë eksperiencë mbi 10-vjeçare si gjyqtar dhe eksperiencë mësimdhënëse universitare në lëndët kryesore ose në Shkollën e Magjistraturës mbi 5 vjet. Vlen për t'u theksuar se për specifikat që ka Shkolla e Magjistraturës, një institucion kushtetues, që siguron formim profesional të magistratëve, përzgjedhja e pedagogëve të Formimit Fillestar dhe trajnerëve apo ekspertëve në Formimin Vazhdues, përbën një nga elementët e realizimit të këtij suksesi, por jo të vetmin, nuk mund të ketë kriterë të ndryshme dhe as dallime ndërmjet pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm, që janë pjesë e formimit fillestar për kandidatët për magistratë, madje as mes tyre dhe trajnerëve apo ekspertëve që janë pjesë pedagogjike e gjyqtarëve/prokurorëve në Formimin Vazhdues. Gjithsesi, mbetet për t'u

diskutuar në mbledhjen plenare se cila nga dy variantet do të marrë shumicën e votave të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Më tej pastaj, në projektvendim, të gjitha kriteret janë të njëjta.

Është përcaktuar kriteri ndalues për komandimin, të parashikuar nga vetë ligji. E gjithë procedura që duhet të ndjekë kandidati. Paraqitja e dokumentacionit. Si operohet pas marrjes së kandidaturave, me përgatitjen e opinionit për çdo kandidat dhe publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit. Pastaj përvjeljen e emrave Shkollës së Magjistraturës dhe pastaj i takon Këshillit Drejtues të kësaj Shkolle që referuar kritereve shtesë të publikuara prej tij, të përzgjedhë kandidatin fitues, i cili në përfundim të këtij procesi i përcillet përsëri Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vendosur për komandimin e tij.

Ky ishte një relacion i shkurtër. Të dy projekt-aktet janë në variantin 1 dhe në variantin 2. Sikurse u relatua, në variantin 1, bazohet në trajtimin e barabartë të kritereve dhe kushteve si për pedagogët e brendshëm, ashtu edhe për pedagogët e jashtëm, bazuar në nenin 264/4 të ligjit 115/2016. Varianti nr. 2 është varianti që bazohet vetëm në kriteret e nenit 264/2 të ligjit.

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Ukperaj!

Kemi ndonjë koment dhe sugjerim?

Dritan Hallunaj: Për sa i përket kësaj pike, unë personalisht, duke qenë që në vendimin nr. 33, datë 19.02.2019, marrë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, unë kam votuar pro variantit, të vendimit pra që është dhe me variantin e parë të sotëm, që e ndryshon, por duke parë nevojat e Shkollës, duke parë problematikat e krijuara, unë personalisht shpreh votën time pro variantit të parë dhe tërhiqem nga qëndrimi që kam mbajtur. Faleminderit!

Naureda Llagami: Po, zonja Shehu!

Marçela Shehu: Edhe unë jam pro variantit të parë, që prezanton sot Komisioni, sidomos për të garantuar barazinë në trajtim midis kandidatëve për pedagogë të brendshëm dhe të jashtëm. Kështu që edhe unë jam dakord me variantin e parë të Komisionit.

Naureda Llagami: Atëherë, kemi komente, sugjerime të tjera?

Kalojmë në votim variantin nr. 1.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Kundër.

Naureda Llagami: Kundër.

Atëherë, miratohet varianti nr. 1 i propozuar nga Komisioni, i cili ka të bëjë me shpalljen dhe rihapjen së procedurës për komandimin e një gjyqtari në pozicionin pedagog i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 09.07.2019)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi krijimin dhe administrimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor të dosjes personale dhe regjistrit të gjyqtarëve”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 15:10 dhe mbaroi në orën 16:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 7. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 8. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 9. Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 10. Marjana Papa, OSCE.*
- 11. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 12. Valbona Bala (Pajo), USAID.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi krijimin dhe administrimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor të dosjes personale dhe regjistrit të gjyqtarëve”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me: Shqyrtimin e projektvendimit “Mbi krijimin dhe administrimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor të dosjes personale dhe të regjistrit të gjyqtarëve”, përgatitur ky projekt-akt nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe do të relatohet nga zoti Erjon Muharremaj.

Erjon Muharremaj: Faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përmbushje të detyrave të tij kushtetuese, për të garantuar mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor dhe për të garantuar efikasitetin e tij, në bashkëpunim me dy partnerët tanë strategjik, Misionit EURALIUS dhe të USAID-it, ka punuar për hartimin e projektvendimit “Për krijimin dhe administrimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor të dosjes personale dhe të regjistrit të gjyqtarëve”, mbështetur kjo në nenet 38 dhe 77 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenet 5, 6, 27 dhe 28 të ligjit 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

Bazuar në këto Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale ka hartuar këtë projektvendim që i hap rrugë krijimit dhe administrimit të dosjes personale për çdo gjyqtar dhe të regjistrit të gjyqtarëve.

Për sa i përket tekstit të projektvendimit është i ndarë në 3 krerë dhe në total prej 20 pikash, si më poshtë:

Në Kreu I të titulluar “Regjistri i Gjyqtarëve”, jepet kuptimi i regjistrit të gjyqtarëve, si një bazë unike e të dhënave profesionale dhe personale të gjyqtarëve, që plotësohet mbi bazën e dosjes personale të çdo gjyqtari. Regjistri do të mbahet në të dy formatet, si shkresor ashtu edhe elektronik, ku regjistri elektronik i gjyqtarëve në fakt, do të jetë një pasqyrim besnik i të dhënave që përmbahen në regjistrin që do të mbahet në format shkresor. Gjithashtu, përcaktohen edhe të dhënat që do të administrohen në regjistrin e gjyqtarëve, ku përfshihen: emri, mbiemri; datëlindja; vendlindja; vendbanimi; arsimimi; kualifikimet dhe trajnimet; pjesëmarrja në aktivitete shkencore; përvoja profesionale; data e emërimit si dhe lëvizjet brenda dhe jashtë sistemit gjyqësor; vlerësimet e etikës dhe të veprimtarisë profesionale; si dhe masat disiplinore. Ky regjistër do të administrohet dhe përditësohet në mënyrë të vazhdueshme, në të dy formatet, nga njësi përgjegjëse për burimet njerëzore të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në vijim, në Kreun II të titulluar “Dosja personale e gjyqtarit”, në projektvendim rregullohet në mënyrë të hollësishme krijimi, përmbajtja dhe administrimi i dosjes personale të gjyqtarit. Secila dosje do të marrë një numër identifikimi të veçantë që krijohet që nga momenti i emërimit të gjyqtarit. Për gjyqtarët që vijnë nga Shkolla e Magjistraturës, dosja personale krijohet mbi bazën e dosjes së përcjellë prej saj. Për

gjqtarët e tjerë, dosja personale krijohet mbi bazën e dosjes së emërimit. Kjo dosje do të administrohet dhe përditësohet në mënyrë të vazhdueshme, në të dy formatet, nga njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore të Këshillit dhe informacioni që do të përfshihet në çdo dosje do të jetë i shoqëruar me dokumentacionin provues. Projektvendimi i ka listuar në mënyrë shteruese këto dokumente, ku parashikon se do të përfshihen: (i) të dhënat personale; (ii) të dhënat familjare; (iii) të dhënat për arsimin e lartë, ato për studimet pasuniversitare, të dhënat mbi aktivitetin mësimdhënës dhe shkencor (iv) të dhënat për formimin fillestar dhe formimin vazhdues; (v) të dhënat për përvojën profesionale dhe zhvillimin e karrierës; (vi) të dhënat për vlerësimin e etikës dhe veprimtarisë profesionale. Në dosjen personale do të pasqyrohen të gjitha të dhënat, sipas përmbajtjes në formatin shkresor dhe ajo elektronike do të pasqyrojë në mënyrë besnike përmbajtjen e dosjes në format shkresor. Secila dosje do të përmbajë si fletë të parë, fletën e inventarit, ku parashikohet gjithçka që do përfshihet në dosjen e gjyqtarit, sipas modelit që i bashkëlidhet në Lidhjen nr. 1, tekstit të këtij projektvendimi dhe në të renditet i gjithë dokumentacioni që do përfshihet në dosje, ku do të përditësohet sa herë që në dosje do të shtohen dokumente të ndryshme. Çdo dokument i përfshirë në dosje merr një numër rendor të veçantë dhe pas marrjes së numrit rendor dhe para vendosjes në dosjen personale në format shkresor, ajo do të skanohet për t'iu bashkëlidhur formatit elektronik të dosjes. Çdo përditësim i fletës së inventarit do të nënshkruhet nga nëpunësi i autorizuar si dhe nga drejtuesi i njësisë së burimeve njerëzore të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Fleta e inventarit e përditësuar do të skanohet dhe gjithashtu bëhet pjesë e dosjes elektronike. Nëpunësit e autorizuar janë përgjegjës për saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave që përfshihen në fletën e inventarit.

Gjithashtu, projektvendimi përcakton detyrimin e gjyqtarit që të njoftojë Këshillin e Lartë Gjyqësor për çdo ndryshim të të dhënave që janë pjesë e dosjes së tij personale, në mënyrë që në çdo moment dosja personale e gjyqtarit të jetë e përditësuar. Gjyqtarët do të njoftohen në postën e tyre elektronike për çdo përditësim që i bëhet dosjes së tyre. Nga ana tjetër, gjyqtari mund të kërkojë ndryshimin dhe plotësimin e të dhënave të tij në rastet kur konstaton pasaktësi dhe është ai që mban përgjegjësi për vërtetësinë e dokumentacionit që paraqitet prej tij, që do të përfshihet në dosje.

Më tej, në Kreun III të titulluar “Rregulla të përgjithshme mbi administrimin e Regjistrit të Gjyqtarëve dhe Dosjes Personale”, përcaktohen në mënyrë më të hollësishme rregullat e përgjithshme për sa i përket administrimit të regjistrit të gjyqtarëve dhe të dosjeve personale. Konkretisht, parashikohet se anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor kanë të drejtë të njihen me të dhënat e regjistrit të gjyqtarëve dhe dokumentacionin e plotë të dosjes personale të gjyqtarit, në të dyja formatet shkresor dhe elektronik. I njëjti akses i garantohet edhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në zbatim të kompetencave të tij. Dosjet në format shkresor ruhen në mjedis të veçantë dhe të sigurt, hyrja dhe ambientet e të cilit janë nën monitorimin e vazhdueshëm të kamerave të sigurisë, për të parandaluar çdo lloj ndërhyrje të paautorizuar. Vetëm nëpunësit e autorizuar dhe drejtuesi i njësisë përgjegjëse të burimeve njerëzore të Këshillit të Lartë Gjyqësor do të kenë akses në ambientet ku fizikisht ruhen dosjet dhe ata duhet të jenë të pajisur me certifikatë sigurie nga autoritetet kompetente.

Gjithashtu, zhvendosja e dosjeve nga ambientet e ruajtjes mund të kryhet vetëm me autorizimin me shkrim të drejtuesit të njësisë përgjegjëse të burimeve njerëzore si dhe të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për sa i përket natyrës së të dhënave të regjistrit dhe dosjes personale të gjyqtarit, projektvendimi përcakton se ato kanë karakter konfidencial. Njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore publikon në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor pjesë të dosjes personale të gjyqtarit dhe të dhëna nga regjistri i gjyqtarëve, të cilat mund të aksesohen nga publiku, si më poshtë: emri, mbiemri; gjykata ku ushtron funksionin; arsimimi; kualifikimet; përvoja profesionale; vlerësimet e etikës dhe veprimtarisë profesionale; dhe së fundmi në pikën e) kërkohet të diskutohet edhe nga ana e të gjithë anëtarëve për sa i përket përfshirjes së masave disiplinore në dokumentacionin e aksesueshëm nga publiku, pasi ne si Komision jemi të mendimit që ndër masat disiplinore, për shkak të vetë karakterit të vet, kemi parashikuar që vetëm ato që konsiderohen “Vërejtje publike”, të jenë të aksesueshme nga publiku. Por për këtë do të doja që të shprehnin mendimin e tyre edhe anëtarët e tjerë.

Gjithashtu, është propozuar që edhe dosjet e gjyqtarëve të periudhës para krijimit të Shkollës së Magjistraturës të përditësohen me dokumentacionin sipas dispozitave të këtij vendimi, për aq sa ato janë të zbatueshme. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave

personale të gjyqtarit bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe me të drejtën e subjektit të të dhënave për mbrojtjen e jetës personale dhe private. Të dhënat mbahen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor vetëm për qëllime të administrimit të sistemit gjyqësor, në funksion të garantimit të vendimmarrjes efektive dhe transparencës në gjykata, ndërsa përpunimi i tyre bëhet vetëm mbi bazën e këtyre qëllimeve.

Në lidhje me afatin e administrimit të dosjes personale të gjyqtarit nga njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore, projektvendimi e përcakton deri në momentin kur statusi i gjyqtarit mbaron për shkak të mbushjes së moshës për pension. Më pas, dosja personale i kalon njësisë përgjegjëse për arkivat, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në mënyrë që dosjet e tyre të arkivohen.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Regjistri i gjyqtarëve plotësohet fillimisht mbi bazën e të gjitha dosjeve personale të gjyqtarëve që administrohen në Këshillin e Lartë Gjyqësor në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Struktura e Njësisë së Burimeve Njerëzore është në gatishmëri të plotë, në mënyrë që të fillojë nga puna menjëherë për të vënë në zbatim këtë vendim. Gjithashtu, përcaktohet se brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, dosjet personale dhe regjistri i gjyqtarëve duhet të jenë të organizuara në përputhje me dispozitat e këtij vendimi.

Siç përmenda edhe pak më sipër, projektvendimit i bashkëlidhet Lidhja Nr.1, ku është parashikuar formati i fletës së inventarit të dosjes personale të gjyqtarit, në rë cilën renditet i gjithë dokumentacioni që përfshihet në dosje.

Në pikën e fundit parashikohet që ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kjo ishte në lidhje me relatimin e përmbajtjes së projektvendimit. Prandaj, propozoj zonja Kryetare, që ju të ftoni Këshillin të diskutojë në lidhje me pikën që ka të bëjë me aksesin nga publiku të masave disiplinore ndaj gjyqtarëve.

Naureda Llagami: Faleminderit për relatimin, zoti Muharremaj!

Atëherë, me sa kuptuam, tek pika nr. 15 tek Kreu “Rregullat e përgjithshme mbi administrimin e regjistrit të gjyqtarëve dhe dosjeve”, ju ngrëni për diskutim çështjen “-

nëse duhet të jenë masat disiplinore në fuqi “Vërejtje publike”, pjesë e dosjes dhe aksesit të publikut në këtë lloj dosjeje”.

A mundet që të japim opinione dhe si e vlerësoni?

Keni një propozim konkret juve?

Erjon Muharremaj: Më fal, vetëm një saktësim, zonja Kryetare.

Ajo çfarë shtrojmë për diskutim është: “-nëse përveç “Vërejtjes publike”, duhet të aksesohen nga publiku edhe vërejtjen e tjera, edhe masat e tjera”. Faleminderit!

Naureda Llagami: Ky është propozim.

Erjon Muharremaj: Gjatë relatimit tim, unë e prezantova që qëndrimi i Komisionit është që publiku të aksesojë vetëm masën disiplinore “Vërejtje publike”. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, për të vijuar diskutimin, propozimi i Komisionit është vetëm për “Vërejtjet publike”. Jemi dakord? Apo kërkojmë që ta shtojmë dhe të përfshijmë edhe masat e tjera?

Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë, arsyeja sepse është paraqitur ky projektvendim lidhet me një detyrim ligjor që ka Këshilli për të krijuar dosjen personale dhe regjistrin e magistratëve/të gjyqtarëve. Kjo dosje personale përmban të dhëna personale por edhe profesionale. Të dhënat për masat disiplinore janë të dhëna profesionale. Dosja mund të jetë e aksesueshme nga publiku në funksion të transparencës dhe të dijë për të gjithë gjyqtarët e sistemit. Dosja mund të përdoret nga institucionet që kanë aksesin e hapur, siç është Këshilli apo Inspektori i Lartë i Drejtësisë, por edhe publiku, në kuadër të transparencës së punës së vetë Këshillit, do duhet të dijë të dhënat profesionale të rëndësishme për karrierën e gjyqtarit. Prandaj mendoj që nuk ka asnjë pengesë, sa kohë edhe vendimet e masave disiplinore të Këshillit janë publike, të mos jenë të aksesueshme nga publiku çdo masë disiplinore që është në fuqi. Pra jo vetëm masa “Vërejtje publike”, por çdo masë tjetër. Faleminderit!

Erjon Muharremaj: Më falni, nëse mundem.

Në fakt, referuar nenit 105, të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, renditja që i bën kjo dispozitë masave

disiplinore, fillon në fakt me atë që është “Vërejtje konfidenciale”, që kuptohet nga vetë natyra e saj që nuk mund të behët publike. Më tej vijon “Vërejtje publike”, të cilën neve në projektin e paraqitur e kemi përfshirë si masë që publiku mund ta aksesojë. Ndërkohë që më tej vijohet me “uljen e përkohshme të pagës”, që ne gjykojmë që nuk përbën ndonjë interes për publikun që të ketë njohuri në lidhje me një masë të tillë. Më tej më pas vijohet me “ulje në detyrë” dhe pastaj “pezullimi nga detyra” dhe “shkarkimi nga detyra”, që këto janë masa që në fakt e bëjnë gjyqtarin jo aktiv. Prandaj ne gjykojmë që ndër të gjitha këto masa të renditura në këtë dispozitë, publiku të ketë akses vetëm tek “vërejtja” që është publike. Faleminderit!

Naureda Llagami: Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Faleminderit!

Në qoftë se do t'i qëndrojmë shumë strikt ligjit, në fakt neni 38, pika 3 dhe 4, parashikon të drejtën e Këshillit që të miratojë rregulla të hollësishme për ato pjesë të dosjes personale dhe regjistrin që aksesohet nga publiku. Pra vetë ligji e parashikon mundësinë që jo të gjitha pjesët e dosjes personale dhe të regjistrin janë të aksesueshëm për publikun. Sigurisht që janë pjesë shumë e rëndësishme e dokumentimit të veprimtarisë profesionale, morale, e integritetit të gjyqtarit, por jo domosdoshmërisht çdo pjesë e dosjes dhe e regjistrin duhet të jetë e aksesueshme.

Pse kemi konkluduar, edhe pas diskutimeve, që një pjesë e masave disiplinore, dhe konkretisht kjo “ulja e pagës” dhe “vërejtja konfidenciale”, apo edhe masat e tjera, nuk duhet të jenë të aksesueshme? “Vërejtja konfidenciale”, siç e tha edhe zoti Muharremaj, automatikisht, për shkak të ligjit nuk duhet të jetë e aksesueshme sepse është konfidenciale dhe për shkak të natyrës, publiku nuk ka ardhur në dijeni të shkeljes. Ndërkohë që për masat e tjera, çështja që shtrohet për diskutim, jo vetëm sot në Këshill, por edhe në Këshillat e tjera, është çështja se sa do të ndikojë për publikun besueshmëria që ai do ketë në gjykimin nga një gjyqtar i tillë. Një gjyqtar që ka masë disiplinore, masa disiplinore i jepet vërtet si një ndëshkim ndaj shkeljes, por ai gjyqtar vazhdon të jetë në funksion dhe vazhdon të gjykojë. Sot, Këshillat, të paktën edhe me aq literaturë sa jemi konsultuar. Kanë qenë dhe qëndrime që në mënyrë automatike masat disiplinore nuk

duhet të jenë të aksesueshme për shkak sepse çdo palë futet në një seancë gjyqësore me një paragjykim ndaj gjyqtarit për të cilësinë e drejtësisë që ai do të japë.

Pikërisht, për këtë shkak kemi vlerësuar që për të mos ndikuar në besueshmërinë e gjyqtarit sepse edhe një gjyqtar që ka masë disiplinore nga këto që duhet të publikohen, do të vazhdojë të gjykojë, për të mos cenuar figurën e gjyqtarit, vetëm “Vërejtja publike”, që për shkak të natyrës së vet është e aksesueshme nga publike sepse jepet për një shkelje që ka impakt në publik, të bëhet e aksesueshme edhe në të gjitha rastet.

Ndërsa, për masat e tjera të mos jenë të aksesueshme, pavarësisht në fakt se vendimet e mbledhjes plenare që do të japin këto masa disiplinore në fakt, do të jenë të publikuara. Domethënë në thelb, nuk është se dëmtohet transparenca.

Naureda Llagami: Atëherë, kemi sugjerim konkret?

Kalojmë në votim të projekt-aktit sipas propozimit të bërë konkret nga Komisioni përkatës?

Këtë propozimin që ka.

Ilir Toska: Ju thashë, këtë pikën e) të konsiderohet që duhet publikuar çdo masë që është bërë publike, që është në fuqi.

Brunilda Kadi: Përveç “Vërejtjes konfidenciale”.

Ilir Toska: Jo “Vërejtja konfidenciale”. Çdo masë publike që është në fuqi.

Naureda Llagami: Atëherë, hedhim në votim propozimin e Ilirit.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Kundër.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Kundër.

Erjon Muharremaj: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Kundër.

Hedhim në votim propozimin e bërë nga Komisioni.

Maksim Qoku: Kundër.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ilir Toska: Dakord, por me pjesën që ishim kundër me pikën e), lidhur me publikimin e masave. Pra pjesërisht kundër. Faleminderit!

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pjesërisht kundër.

Naureda Llagami: Dakord.

Dritan Hallunaj: ...shpjegova votën, për efektin se votova pro pjesës që të ishin të gjitha vërejtjet të shënuara. Për aktin jam 'Pro'.

Maksim Qoku: E njëjta gjë edhe për mua.

Jam për idenë që të jenë.

Të tjerat në rregull.

Atëherë, Këshilli miratoi projektvendimin "Për krijimin dhe administrimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor të dosjes personale dhe regjistrimit të gjyqtarëve", sipas propozimit të bërë nga Komisioni përgjegjës.

Në fakt unë përfitoj nga rasti që t'ju them që ditën e premte ne do kemi mundësi që përveç miratimit të këtij projekt-akti, ta shohim këtë projekt-akt të zbatuar, pasi siç e dini, me mbështetjen e EURALIUS-it dhe të Ambasadës Britanike, Këshillit i është mundësuar krijimi i një softueri (*software*), për të na lehtësuar krijimin e dosjes në mënyrë elektronike. Besoj që të premtën do kemi një prezantim të detajuar për përdorimin e këtij softueri (*software*) nga ana e Këshillit, por jo dhe vetëm nga ana e Këshillit.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 09.07.2019)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një shtesë në vendimin nr. 25, datë 07.02.2019 “Mbi informacionin periodik të kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarisë gjyqësore”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 15:10 dhe mbaroi në orën 16:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 7. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 8. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
- 6. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë institucionit.*
- 7. Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.*
- 8. Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
- 9. Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 10. Marjana Papa, OSCE.*
- 11. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 12. Valbona Bala (Pajo), USAID.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një shtesë në vendimin nr. 25, datë 07.02.2019 “Mbi informacionin periodik të kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarisë gjyqësore”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek projekt-akti i fundit, i cili siç jeni në dijeni, bëhet fjalë për një rishikim, për një shtesë të vendimit nr. 25, datë 07.02.2019 mbi

informacionin periodik të kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore. Dhe ky projekt-akt i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe do të relatohet nga zonja Kadi.

Brunilda Kadi: Faleminderit, Kryetare!

Atëherë, bazuar në vendimin nr. 25, 07.02.2019 për informacionin periodik të kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore. Në zbatim të këtij vendimi, pothuajse pjesa më e madhe e kryetarëve të gjykatave të gjithë republikës, kanë sjellë informacion pranë Këshillit, informacion që është i aksesueshëm nga të gjithë ju. Nga ana e specialistes juristes së Këshillit është përpiluar një memo përmbledhëse dhe mbi bazën e kësaj, nga ana e Komisionit është bërë një raport, duke evidentuar çfarë problematikash kemi parë ne më të rëndësishme për t'ia sjellë mbledhjes plenare dhe nga kjo, kemi ardhur me sugjerimin dhe me propozimin për të bërë një ndryshim tek vendimi, konkretisht, për t'i bashkëngjitur këtij vendimi të miratuar në datë 07.02.2019, një formular standard, në bazë të të cilit do jepet informacioni nga të gjithë kryetarët e gjykatave.

Atëherë, nga njohja e këtij informacioni, shkurtimisht do paraqesim disa probleme. Së pari është konstatuar se informacioni ka ardhur në forma të ndryshme nga njëra gjykatë te tjetra, dhe në një pjesë të konsiderueshme e pakuptueshme ose edhe e paplotë.

Në këto kushte, nga ana e Komisionit tonë, është vlerësuar si i nevojshëm një shtesë në vendimin nr. 25, datë 07.02.2019, duke përfshirë një formular tip, sipas të cilit do të dërgohet informacioni i kërkuar. Ky parashikim në vendim do të bënte: të kuptueshme, nga ana e dërguesve të këtij informacioni se çfarë duhet të përcjellin konkretisht në këtë informacion; do bënte të mundur që informacioni të ishte i plotë dhe sipas asaj që kërkohet dhe; që të jetë i unifikuar për të gjithë gjykatat, për të mundësuar krahasimet dhe përpunimin e tij.

Së dyti, -ndoshta janë shumë të detajuara dhe ju e keni një kopje të këtij raportimi. Së pari, - unë do ndalem shumë shkurt në secilën nga këto problematika, - është përcjellë ngarkesa e pjesës më të madhe të gjykatave, se një pjesë e gjykatave nuk ka raportuar ose nuk ka raportuar si duhet, kanë sjellë ngarkesën totale, por jo një mesatare për secilin

gjqtar. Nga aq sa është perceptuar nga ky informacion, problematikat që vërehen nga ana e Komisionit tonë për periudhën janar – mars 2019, së bashku me sugjerimet, janë si më poshtë:

Në lidhje me ngarkesën e çështjeve gjyqësore për gjykatë dhe çdo gjyqtar, konstatohet se gjykatat që japin informacionin sipas Aneksit nr. 1, që ju e keni bashkëngjitur tek materialet tuaja, dhe unë thjesht do ndalem në disa gjykata që konstatohet një numër i madh çështjesh për gjyqtar, siç është ajo e Kurbinut me 179 çështje/gjyqtar, Shkodra me 266 (bëhet fjalë për gjykatat e rretheve gjyqësore), Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, që ka edhe një tregues të pashpjegueshëm të shpërndarjes së ngarkesës midis gjyqtarëve, për shembull kryetarja ka 80 çështje, ndërsa 2 gjyqtarët e tjerë kanë 5-fishin. Është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçës me një ngarkesë shumë të madhe, 404 çështje/gjyqtar. Ajo e Shkallës së Parë Vlorë... Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka një ngarkesë mesatare prej 108 çështjesh por ka një diferencë të theksuar midis shpërndarjes dhe çështjeve midis gjyqtarëve. Apeli Durrës, ka 196 çështje/gjyqtar (apeli civil). Apeli i Korçës, 128 (këto nuk janë tek ngarkesa). Apeli i Tiranës raporton një ngarkesë totale jo për gjyqtar. Ndërkohë Gjykata e Apelit Administrativ, paraqet dukshëm një diferencë të dukshme të çështjeve që kanë në ngarkim gjyqtarët, sipas tabelës së mëposhtme, që e keni aty tek raportin (s'po ndalemi).

Ajo që vihet re është një ngarkesë shumë-shumë e madhe, pothuajse për të gjithë gjyqtarët edhe çështje të prapambetura të 2014, 2015, 2016. Një sërë gjykatash nuk kanë raportuar ose e kanë sjellë informacionin në tërësi të pandarë për secilin gjyqtar.

Arsyet kryesore të kësaj mbingarkese lidhen me mungesat e gjyqtarëve për shkak të largimit apo pezullimit nga procesi i rivlerësimit; ndryshimet e fundit të kodeve të procedurave civile dhe penale; mosfunksionimi i sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve që në disa gjykata nuk garanton barazinë në shpërndarje.

Në fakt, ajo që ne kemi vlerësuar, konstatuar nga ky raportim është që nuk mund të konsiderohet si shkak për mbingarkesë mungesa e produktivitetit të gjykatave sepse numri i çështjeve të përfunduara prej tyre referuar raportimit është i lartë.

Në përmirësimin e kësaj situatë, do të ndikonte, sipas sugjerimit tonë, kryerja nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor të procedurave për emërimin dhe caktimin në detyrë të magistratëve të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës; plotësimin për kohësisht i pozicioneve të lira të përkohshme, nëpërmjet skemës së transferimit me ose pa pëlqim; ndërhyrja në sistemin e menaxhimit të çështjeve; dhe miratim të rregullave për mënyrën e shpërndarjes së çështjeve me short sipas pikës 3 të nenit 25 të ligjit nr.98/2016.

Në lidhje me çështjet e mbartura, keni Aneksin II, ku gjykata të ndryshme kanë problematika të ndryshme.

Edhe për çështjet e zvarritura, po kështu i keni tek Aneksi, që mund t'i referoheni.

Për sa i përket respektimit të etikës dhe solemnitetit nuk raportohet ndonjë problematikë.

Në lidhje me kërkesat për heqje dorë të gjyqtarëve dhe të pranuar nga kryetarët, konstatohet se ka një numër relativisht të madh. Shkaku i tyre nuk evidentohet. Për këtë arsye, sipas formularit që propozohet për të qenë pjesë e vendimit, do të kërkohet edhe pasqyrimi i shkakut të dorëheqjes së pranuar, me qëllim që të kuptohet nëse ka rast për ndërhyrje nga ana e Këshillit. Për këtë arsye është sugjeruar që të jenë sipas formularit që do lexohet më pas (të jenë të përgjithshme).

Në lidhje me përdorimin e sistemit të regjistrimit audio, vihet re që ka diferenca të mëdha midis disa gjykatave. Nuk jepen shpjegime për arsyet e mospërdorimit, por nga ajo që kuptohet, shkaku kryesor është mungesa e sallave. Në lidhje me këtë, ajo që sugjerohet është: studimi nga ana e Komisionit të Planifikimit Strategjik Administrimit dhe Buxhetit, i situatës në këto gjykata dhe mundësia për të ndërhyrë me investime në gjykatat që e kanë të theksuar këtë situatë, siç është ajo e Gjykatës së Tiranës, që është gjykata më e madhe në vend dhe që përballon ngarkesën më të madhe, është gjykata që ka përqindjen më të ulët të përdorimit ose të zhvillimit të seancave audio.

Në lidhje me sistemin, që prej vitit 2017 për sistemin e menaxhimit të çështjeve ICMIS nuk ofrohet shërbim mirëmbajtjeje dhe zhvillimi i mëtejshëm i sistemit. Në këtë situatë, sugjerohet një ndërhyrje sa më e shpejtë për të investuar me prioritet në përmirësimin e infrastrukturës të këtyre gjykatave.

Për sa i përket problemeve të hasura në përdorimin e këtij sistemi, janë shumë problematikat e evidentuara nga pjesa më e madhe e gjykatave. Nuk po i lexoj. I keni të listuara (se është një listë prej 25 problematikash).

Në këto kushte, sugjerohet që të shihet me shumë prioritet ndryshimi i këtij sistemi dhe unifikimi për të gjithë gjykatat.

Për dorëzimin e dosjeve me vonesë, raportohet nga 13 gjykata se ka raste të këtyre vonesave. Një pjesë shoqërohet me shpjegim, një pjesë jo.

Për sa i përket informacionin të fundit sipas pikës “g” të vendimit, ku sugjerohet dhe u kërkohet kryetarëve të gjykatave të sjellin do problematikë tjetër, është evidentuar që nga 38 gjykatat, 16 prej tyre kanë përcjellë disa probleme, të cilat janë të natyrave të ndryshme dhe të pasqyruara me hollësi në memon e përgatitur nga juristja. Në lidhje me këtë informacion, është konstatuar se, nga pjesa më e madhe e kryetarëve të gjykatave nuk është kuptuar drejt vendimi nr.25. Në këtë vendim, si dhe del nga objekti dhe përmbajtja e tij, kërkohet informacion periodik në lidhje me veprimtarinë gjyqësore, dhe këtë natyrë duhet të ketë edhe informacioni i kërkuar sipas germës “g”, dhe jo çdo lloj problematike që ata hasin në administrimin e përditshëm të gjykatave. Për këtë konstatim, në formularin tip që propozohet të shtohet, bërë sqarim plotësues për t’u kuptuar në këtë mënyrë, kjo kërkesë e vendimit.

Ky është raportimi.

Për sa i përket, siç u tha tek pika e parë e raportimit, nga Komisioni ynë propozohet një projektvendim për të shtuar tek vendimi nr. 25 formularin tip, që e keni bashkëngjitur, për të cilin, nga ana e Komisionit është marrë mendimi edhe i kryetarëve të gjykatave, janë marrë parasysh edhe sugjerimet e tyre për sa i përket vërejtjeve që kishin, sqarimeve të mëtejshme apo edhe shtimit të ndonjë rubrike. Ajo që propozohet nga ne është të miratohet ky projektvendim për të shtuar në vendimin nr. 25, datë 07.02.2019 “Mbi informacionin periodik të kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore”, në pikën 3, në fund të fjalisë, të shtohet togfjalëshi “sipas formularit tip bashkëngjitur këtij vendimi”. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Formularin tip e

keni bashkëngjitur. Informacionin, -se ndoshta s'ka kuptim që të lexohet tabela, -e keni të gjithë. Ky është propozimi ynë.

Naureda Llagami: Atëherë, faleminderit zonja Kadi, për sqarimet ezauroese mbi nevojën e propozimit të ndryshimit të projektvendimit, duke i bashkëlidhur vendimit të mëparshëm një formular tip.

Nëse nuk kemi diskutime apo komente lidhur me projekt propozimin e bërë nga Komisioni përkatës, kalojmë në votimin e projekt-aktit, sipas propozimi të bërë nga Komisioni?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, projektvendimi miratohet sipas propozimit të bërë nga Komisioni përkatës.

Nëse nuk kemi ndonjë gjë tjetër, ndonjë çështje tjetër diskutimi?

Ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe për punën e bërë të dy Komisionet.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor